



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
MINISTRI

Rruga: "Durrësit", Nr. 23, AL- 1001, Tiranë – SHQIPËRI

www.mash.gov.al

Tel: 00 355 4 226 307

Nr. Prot.

Tiranë, më

U D H Ë Z I M

Nr. 17, Datë 15.04.2008

PËR

**“PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTËVE TË SHKOLLAVE TË MESME PËR
PROGRAME TË NDRYSHME STUDIMI NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË
ARSIMIT TË LARTË, SI KRITER I PËRGJITHSHËM I PËRZGJEDHJES SË
KANDIDATËVE NË VITIN AKADEMIK 2008 – 2009, NË CIKLIN E PARË
TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË”**

Mbeshtetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si edhe të pikave 1 e 5 të nenit 33 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në zbatim të VKM nr. 78, datë 08.02.2006 “Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”

U D H Ë Z O J :

1. Përcaktimin e koeficientëve të shkollave të mesme për programe të ndryshme studimi në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, si kriter i përgjithshëm i përzgjedhjes së kandidatëve në vitin akademik 2008-2009, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, sipas tabelave bashkëngjitur, në bazë të propozimeve të Institucioneve publike të Arsimit të Lartë e të Drejtorisë së Politikave të Arsimit të Lartë.

2. Institucionet publike të Arsimit të Lartë, Drejtoritë Arsimore Rajonale, Zyrat Arsimore, të gjitha drejtoritë e shkollave të mesme dhe të gjithë maturanët\kandidatët e interesuar për t’u pranuar në Institucionet publike të Arsimit të Lartë të njihen me koeficientët sipas tabelës bashkëngjitur.



3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Pergjithshem, Zëvendësministri i Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Kurrikulës, Drejtoritë Arsimore Rajonale, Zyrat Arsimore si edhe drejtuesit e Institucioneve publike të Arsimit të Lartë.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

GENC POLLO